



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 647 prot.

Shkodër, më 22.02.2021

V E N D I M

Nr. 54, datë 22 . 02 .2021

"Për miratimin e Rezolutës për kriterin e notës mesatare"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, germa "a" dhe Statutin e USH-së, Neni 17, pika 6, germa "a", Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim Rezolutën e Asamblesë së USH-së, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2021

Vendosi:

1. Të miratojë Rezolutën e Asamblesë së USH-së bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË
Prof. dr. Suzana GOLEMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 647 / prot.
11

Shkodër, më 22.02.2021

REZOLUTË

Senati Akademik:

- Duke vlerësuar parimet e autonomisë dhe lirisë akademike të institucioneve të arsimit të lartë, parashikuar nga Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015;
- Duke vlerësuar që programet e studimit *Bachelor* në: Biologji-Kimi, Fizikë, Hi stori, Gjeografi, Gjuhë-Letërsi, Informatikë, Matematikë, Psikologji, por edhe Gjuhë Angleze, Gjuhë Italiane, Gjuhë Frënge dhe Gjuhë Gjermane, janë vetëm programe formimi të përgjithshëm;
- Duke vlerësuar që me diplomën "Bachelor" mund të punësohesh në sektorë të ndryshëm të administratës publike apo private, por jo mësues;
- Duke vlerësuar që për *programet e studimit të ciklit të dytë në Mësuesi* mund të vendosen kritere merite për përzgjedhjen e studentëve;

konstaton se:

- Vendosija çdo vit, përmes VKM-ve e notës mesatare në progresion rritës, është përjashtuese dhe ka lënë jashtë të drejtës për arsimin e lartë një numër të madh maturantësh, të cilët u janë drejtuar shteteve të tjera fqinje apo evropiane. Këta studentë që ne nuk i pranojmë për shkak të notës mesatare, në universitetet e huaja dalin me rezultate të mira dhe shumë të mira.
- Vendosija e kriterit të notës mesatare si kriter hyrës, nuk zbatohet në universitetet evropiane nënshkruese të Deklaratës së Bolonjës, ku bëjmë pjesë edhe ne (studentët testohen me konkurse publike) as në vendet fqinje.

- Kërkesa për cilësi është prioritet i strategjisë së mësimdhënies në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe ai e realizon këtë detyrë për të përmbushur misionin e tij. Prej këtij universiteti, në përfundim të studimeve dalin studentë shumë cilësorë, mesatarë dhe të dobët, në të gjitha programet e studimit. Tregu i punës apo Ministria ka mundësinë që të përzgjedhë për të punësuar nga këto kategori, sipas kriterit të aftësisë dhe cilësisë më të lartë.

- Klasifikimi i disa programeve të studimit *Bachelor* si programe studimi “Mësuesi” është i pasaktë në raport me drejtimit që marrin studentët (p.sh. me *Bachelor në Biokimi* studentët mund të ndjekin *Master në Biologji Mjedisore*, me *Bachelor në Gjeografi* studentët mund të ndjekin *Master në Gjeografi Mjedisore*). Diploma *Bachelor* është diplomë e formimit të përgjithshëm dhe jo diplomë profesionale që detyron studentët të ndjekin drejtimin “Mësuesi”.

**Mbështetur në sa më sipër, si dhe në kërkesat e studentëve dhe pedagogëve
Senati Akademik i kërkon Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që:**

- a) Të konsiderojë kriterin e notës mesatare për pranimet e reja, në të gjitha ciklet dhe në të gjitha programet e studimit si pjesë e autonomisë së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe t’ia kalojë vendimmarrjen universitetit tonë.
- b) Të implementojë mekanizma dhe reforma për të nxitur studentët që të zgjedhin programet e studimit të drejtimit “Mësuesi” duke u fokusuar te *programet e studimit të ciklit të dytë në Mësuesi* dhe jo që në programet *Bachelor*, të cilat nuk janë të këtij drejtimi.

KRYETARI

Prof. Dr. Suzana GOLEMI